



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr. 06-220392023

Klinë, dt. 05.07.2023

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës të mbajtur me datë 13. 02. 2023 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Pjesëmarrës në mbledhje është kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, nënkryetarja e Komunës, znj. Marqe Selmani, komandanti i policisë, z. Ragip Bytyqi, drejtorë të drejtorive, media lokale si dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i Kuvendit z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë të pranishmit. Kryesuesi tha përveç të tjerave se këtë seancë është e thirrur nga kryetari i Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj.

**Pika e vetme e rendit të ditës është : Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore- vërshimet në komunën e Klinës në janar 2023.**

Kryesuesi po ashtu kërkoi që me një minutë heshtje të solidarizohen me viktimat e tërmetit në Turqi dhe Siri.

Kryesuesi gjithashtu konstatoi se prezent janë 27 anëtarë të kuvendit dhe më pastaj fjalën e morri drejtori i shërbimeve publike, z. Qendrim Millaku.

**z. Qendrim Millaku, drejtor i DSHPE:** Të nderuar po ju drejtohem për herë të dytë brenda dy muajve për të raportuar për dëmet e shkaktuara në Komunën tonë.

z. Millaku në vazhdim bëri një përshkrim të hollësishëm të rrjedhjes së ngjarjeve natën dhe ditët e përmytjeve nga vërshimet. Ai foli duke përshkruar se si janë përmytur të gjitha pjesët e vendbanimeve, rrugëve dhe të arave nëpër fshatra të komunës pa harruar të falënderoj ata që kanë kontribuar me mjetet e tyre si kompanitë "Dreoni" me pronar Naser Kalludra, "Valcem" me pronar Rasim Qupeva, "Hidrodrini", mulliri "Jeta e re" me pronar Elmi Qupeva dhe kompania "AIM" me pronar Arben Maloku. Falënderon edhe Policinë e Klinës, njësinë e zjarrfikësve, njësitë e kërkim shpëtimit nga Gjakova, Suhareka, Rahoveci. Z. Millaku tha se janë vizituar menjëherë të gjitha vendet e përmytura dhe kryetari ka formuar menjëherë komisionin për vlerësimin e dëmeve. "Ky komision ka bërë një punë të intensive dhe të madhe për çka i falënderoj shumë për punën e tyre. Këtë raport e keni ju sot përballë" tha z. Millaku.

Drejtori i shërbimeve publike dhe emergjente tregoi edhe për donacionet në pako ushqimore të pranuar nga kompani të ndryshme. Po ashtu edhe për ndërhyrjet që si komune janë bërë në

kanalizime dhe lumenj menjëherë pas vërshimeve si dhe tregoi në detaje se sa kub zhavorr janë përdorur deri me 31. 01. 2023.

Pas raportimit të drejtorit Millaku, hapet debat.

**z. Esat Raci:** Përshëndetje. Bashkndejmë me të gjithë ata qytetarë të prekur nga vërshimet. Unë kam pyetje dhe shqetësime. 1. Kemi marr një material me datë 7 shkurt i nënshkruar nga anëtarët e komisionit ndërsa tani para 15 min. na vjen një raport tjetër të nën shkruar nga të njëjtit anëtarë të komisionit. Pyetja: cila është valide? Kjo e para 15 min. apo ajo e para? 2. A ka qenë vetëm ky komision prej 5 anëtarëve apo ka pasur edhe anëtarë të tjerë komisioni? 3. Kemi qytetarë që na kanë telefonuar se ka qytetarë që nuk janë vlerësuar realisht dëmet e shkaktuara, po ashtu ka vërejtje që në disa raste janë mbi vlerësuar. 4. Kërkoj që qytetarët që nuk ju ka vlerësuar realisht dëmi të ju bëhet një rishikim.

**z. Arben Limanaj:** Përshëndetje. Në pamje të parë si dokument raporti duket i mangët sepse nuk e kemi të specifikuar. Ne si grup kuvendar kemi marrë disa njoftime dhe ankesa nga banorët e prekur se vlerësimet e dëmeve nuk është bërë real. Nuk po përmend emra ashtu siç i kam këtu por që një rast konkret. Një bashkëvendës i yni që jeton jashtë Kosovës, thotë se nuk ju ka vlerësuar dëmi i shkaktuar në shtëpi- Astrit Bojaj dhe babait të tij. Sipas tyre dëmi është 4 fish më i madh se sa vlerësimi i komisioni. Po ashtu edhe Rifat Desku në lagjen Malishgani ka ankesë në lidhje me vlerësimin e dëmeve që i janë bërë. Ai ka bërë ankesë në komisionin komunal. Ankesë për mos vlerësim të drejtë ka edhe në fshatin Shtaricë. Në familjet e Selim dhe Fazli Tafilaj nuk janë bërë vlerësime të drejta ndërsa tek familja e Qenan Tafilaj, komisini nuk ka qenë fare edhe pse gjendet në afërsi të lumit. Sa kam informacion këto familje janë në perëndim por komisioni është dashtë ta kryej punën. Ka ankesë edhe nga Ramë Bajraktari në Resnik tek i cili sa herë ka të reshura ujërat e zeza të fshatit i futen në shtëpi. Unë për vete dyshoj në ndërhyrje edhe pse komisioni mbase e ka kryer mirë punën. Sidoqoftë këtë raport duhet at votojmë dhe të ndihmohen qytetarët e prekur.

z. Limanaj vazhdoi tutje në lidhje me raportin për ta përmbyllur me: “ Nëse janë vendosur në këtë raport familje që nuk janë prekur nga vërshimet, organet kompetente duhet ta thonë fjalën e tyre:.

**z. Zafer Gashi:** Përshëndetje. Ne si grup kuvendar jemi solidarizuar me të gjithë ata që kanë pësuar nga vërshimet. Unë e kam parë kryetarin, drejtorin e shërbimeve, drejtorin e inspektoratit, urbanizmit, kadastrit që kanë qenë të angazhuar. Edhe herën e kaluar që patëm një vërshim me përmasa më të vogla e patëm bërë një listë e cila nuk është përmbushur dhe nuk janë kompensuar dëmet. Duhet të jemi më serioz në lidhje me dokumentet ashtu siç tha z. Raci. Kemi marr dy raporte dhe duhet ta dimë se cilin ta votojmë.

z. Gashi foli tutje për dëmet e krijuara tek bizneset dhe tha se është bërë një padrejtësi, konkretisht për një biznes që është “Central park” i cili biznes 20% është në territor të Malishevës. Vetëm 200 metra largësi nga ky biznes, dy biznese të natyrës së njëjtë, pozicione të njëjta, marrin shumë shuma më të mëdha. Z. Zafer Gashi foli duke përmendur vetëm numrin identifikues edhe për një biznes tjetër që është autoservis . “ Ne si grup kuvendar në takime me ministra dhe zëvendësministra të cilët kanë ardhur me u taku me kryetarin vazhdimisht kemi kërkuar që Komuna e Klinës të ndihmohet sepse është pas Mitrovicës më e dëmtuara” tha në fund z. Zafer Gashi.

**Znj. Blerina Gashi:** Përshëndetje. Pyetja e ime është: A është bërë bartja e mjeteve tek qytetarët që kanë pësuar dëme nga vërshimet e muajit dhjetor dhe sa janë dëmet në sektorin e bujqësisë?

**Znj. Marigona Racaj :** Përshëndetje. Në vërshimet e fundit për fat të mirë nuk kemi pasur dëme në njerëz. Nuk jam shumë në pajtim që janë bërë vlerësime korrekte në këtë raport. Ka familje që kanë pasur dëme dhe nuk i keni evidentuara në fshatin Shtaricë. Mendoj që duhet të rishikohet edhe një herë.

**z. Kushtrim Haliti:** përshëndetje. Edhe unë i kam disa vërejtje në këto lista që na i keni dërguar. Vërejtja e parë është se 10 min. para se me filluar mbledhja na keni dërguar një listë që ka ndryshime prej 200.000 euro. Po ashtu nr. 18- 7000 euro, nr. 57-3616 euro etj. Nëse i ka marr vërshimet këta dy familje atëherë është dashtë të i merr krejt Klinën vërshimet. Në lagjen Dukagjini nr. 82 ju ka bërë dëme më shumë se 12 mijë euro ndërsa komisioni e ka vlerësuar me 1000 e diçka euro. Numrit 99 nuk i ka hy fare uji brenda por vetëm tek drutë , ja kanë vlerësuar me mbi 4000 euro. Nr. 155 prej të njëjtit vend jam edhe unë, nëse këtë do ta kishin përfshi vërshimet është dashtë me e marrë komplet Jashanicën.

z. Haliti në fund tha se komisioni është i përbërë nga 5 anëtarë ndërsa drejtori tha se kanë qenë 15, pse nuk janë emrat e të tjerëve.

**Znj. Besiana Gashi:** Përshëndetje. Doja një shpjegim se pse qytetari me numër rendor 300 është i njëjti edhe tek numri 315 dhe me ndryshime të shumave ashtu sikurse është numri 255 dhe personi i njëjtë është tek numri 355?

**z. Enver Gashi:** Përshëndetje. Duke lexuar raportin shohim se dëmet janë shumë të mëdha. Bazuar në këtë raport dëmet janë mbi 4 milion euro. Gjendja ishte e rëndë nga përmbytjet e lagjeve të Klinës dhe shumë fshatra. Dëme të konsiderueshme janë edhe në ekonomi familjare, biznese e restorante. Shqetësuese është fakti se brenda dy muajve ndodhën dy përmbytje nga vërshimet. Kërkoj nga Komuna dhe qeveria e Kosovës që sa më shpjet të ju ndihmohet të prekurve nga vërshimet.

**z. Valmir Bacaj:** Përshëndetje. Thirrja e seancës së jashtëzakonshme për trajtimin e kërkesave që qytetarët kanë për dëmet e krijuara nga vërshimet tregon qartë për përkushtimin dhe kujdesin që ekzekutivi ka për qytetarët tanë. Pas vlerësimit preliminar tani më kemi një raport të dëmeve por sfidë mbetet se si do të kompensohen dëmet pasi që komuna e Klinës nuk ka ndonjë buxhet të veçantë për trajtimin e këtyre rasteve. Mbetët që qeveria e republikës të ndaj shumën e kërkuar për kompensim.

z. Bacaj tha se nëse ka ankesa të shumta mbi vlerësimet e bëra atëherë kryetari ka mundësi të krijoj një komision në ditët në vazhdim dhe të i trajtoj këto raste. Por që ky raport duhet të votohet pasi që është urgjencë që të shkoj ën qeveri.

**Znj. Lirie Gashi:** Përshëndetje. Pas këtij raporti që e dëgjuam kemi ankesa të shumta në lidhje të hyrjes ose të mos hyrjes në listë. A ka mundësi që me jua lënë një mundësi juridike për ankesë ata që janë hy në listë dhe ata që nuk janë hy në listë.

**z. Tunë Dedaj:** Përshëndetje. Dua ta falënderoj kryetarin e komunës dhe drejtorin për shërbime publike për angazhimin e tyre, për formimin e komisionit. Sipas mendimit tim komisioni ak qenë shumë real. E ka kryer punën e vet shumë mirë dhe kërkoj nga qeveria që të i ndaj mjetet.

**z. Esat Raci:** Me këmbëngulësin më të madhe kërkoj që të gjendet mundësitë buxhetore që komuna vet me ju dalë në ndihmë. A lejohet të hiqen dy, tre apo katër projekte kapitale të këtij viti dhe të ju dilet në ndihmë qytetarët e prekur nga vërshimet.

**z. Fadil Gashi (si anëtar i kuvendit jo si kryesues):** E kam për obligim me e falënderuar komplet ekzekutivin për angazhimin e madh gjatë kohës së vërshimeve përfshi këtu, kryetarin, drejtorin, ekzekutivin, Esat Racin që ka dalë aty bashkë me ne. Ne po flasim për humbje, për dëme, për familjet tona dhe po më bënë përshtypje se asnjë fjalë nuk po flitet për mundësitë e parandalimit të këtyre fatkeqësive, por vetëm për pasojat. Unë e di që ministria e planifikimit hapësinor e ka kontraktuar një projekt dhe janë duke u punuar hartat e zonave të rrezikuara nga vërshimet dhe përmytjet. Kemi zonat e caktuara edhe ku bëhen vërshimet edhe përmytjet. Klina i ka. Kur e përmendim Klinën ju e shihni sa e pa drejtë i behet Klinës në këtë rast. Klina nuk po përmendet shumë dhe kur nuk përmendet shumë edhe nuk trajtohet qysh duhet. E di që vlerësimet e dëmeve janë edhe më të mëdha në komunën e Klinës se që janë në këtë raport. Unë e falënderoj një komunë tjetër të Kosovës që është solidarizuar me Klinën dhe i akne nda 10 mijë euro ndihmë. Po ashtu më bëri përshtypje të keqe se si bashkësia islame bënë thirrje për ndihmë në komunën e Skenderajt e jo edhe për komunën e Klinës.

**z. Gashi foli tutje duke bërë thirrje që të shihet për të ardhmen në parandalimin ose minimizimin e dëmeve të mundshme e për këtë ai tha se duhet që ta ndihmojmë edhe ekzekutivin. "Pse deri në vitin 90 komuna e Klinës nuk ka lëshuar leje ndërtimi për asnjë objekt që ka pasur podrum, projektin për lumin Klina e e ka bërë një kompani e Shkupit e cila e ka bërë edhe për Vardarin dhe nuk është kompletuar projekti për shkak të ndërhyrjes së një ish zyrtareje serbe në atë kohë që ja ka ndërruar rrjedhjen e lumit dhe ne tash përballemi me pasojat e vërshimeve nga ky lum. Ne duhet gjithsesi që të ndërmarrim veprime të preventives sepse sipas gjitha parashikimeve me këso probleme do të merremi edhe në të ardhmen. Duhet ta orientojmë investimet që sa më larg të i mbajmë këto fatkeqësi të mundshme. \_ tha z. Fadil Gashi në fjalën e tij. Ai me tutje tha se komisioni sipas rregullores ka të drejt që të ndërtoj nën komisione sipas udhëzimeve dhe rregullores prandaj mos u hamendësoni pse përveç 5 anëtarëve të komisionit ka pas edhe anëtarë të tjerë. Ne teren është shumë vështirë që të punohet, sidomos me qytetarë të prekur nga këto fatkeqësi, prandaj duhet që të i kuptojmë vështirësitë e këtij komisioni që ka pasur gjatë punës së tij, tha z. Fadil Gashi.**

Në fund, z. Fadil Gashi tha se është mirë që të i shohim zonat e përmytjeve duke kërkuar edhe një herë që në të ardhmen të shohim të gjithë së bashku se si të parandalojmë këto dëme të krijuara nga vërshimet.

**z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE:** Mendoj që i the të gjitha kryesues. Dallimet që po thuhet këtu nuk qëndrojnë. Nuk janë dëmet e krijuara vetëm andej nga kalon uji por edhe tek shembjet e tokës. 36 fshatra janë përfshi nuk është mriz të thuhet se ka pas vlerësime politike, konceptet politike nuk duhet me na nda në këso rastesh. E sa i përket kryeministrit, ai nuk ka denjuar që të na bëjë as edhe një vizitë e interesim, të paktën një përkrahje morale me na e dhënë.

z. Zafer Gashi, e përmendi edhe një herë rastin e autoservisi i cili herën e parë me siguri nuk ka arritë që të bëjë vlerësimin e dëmit të vet ndërsa kësaj radhe duket që është më mirë. Sa i përket kryeministrit , ai ka pasur axhenden e zënë me siguri por dijeni që ai edhe kur është në makinë është duke lexuar ndonjë vepër apo roman, nuk rrinë kot, kurrë nuk flenë. Ka pasur ministra e zv. Ministra që e kanë takuar kryetarin Elezaj.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Përsëritet për të gjithë anëtarët e kuvendit dhe të pranishmit në sallë. E bashkëndej fatkeqësinë natyrore që ka ndodhë, me të gjithë ata që janë prekur. Edhe komisionit i kam thënë që të jenë real. Nuk ka ndjenjë më të vështirë se sa kur të hyjë uji brenda në shtëpi. Një ju garantoj, se asnjë ndërhyrje politike nuk është bërë. Komisioni i themeluar është shtuar me nën komisione sepse ka qenë e pamundur që të përfshihen komplet familjet e prekura. Ndryshimi i vlerave, jam konsultuar edhe me zyrën ligjore. Nuk ka udhëzim administrativ që e rregullon çështjen e ankesave dhe themelimit të një komisioni për shqyrtimin e ankesave. I kam këshilluar anëtarët e komisionit që të bazohen në argumente, ka forma të argumentimit dhe se çdo formë e argumentimit të merret parasysh, lista e re është me rishikim të ankesave. Jemi munduar që të jemi të arsyeshëm në çdo vërejtje të dhënë. Edhe pas aprovimit të këtij raporti ne prap duhet të jemi të hapur për çdo argument që qytetarët na i ofrojnë për dëmet e krijuara. Klina nuk e ka marr vendin e merituar por me këtë raport shpresoj që do të gjejë mirëkuptim dhe trajtim tek qeveria. Shpresat për kompensimin e dëmeve i kemi tek fondet që do të i ndaj qeveria. Ideja është që të aprovohet sot ky raport dhe të lihet hapur mundësia që në seancat e ardhshme të ndryshohet me aprovim të anëtarëve sipas nevojës dhe rasteve të argumentuara. Falënderoj Komisionin dhe të gjitha institucionet , kam dëgjuar fjalë të mëdha për ekzekutivin, zjarrfikësit, policinë, qytetarët e Klinës që kanë qenë të gatshëm që të kontribuojnë në tejkalimin e situatës. Të gjithë kanë qenë shumë të angazhuar. Kryesuesi e tha shumë mirë- çka në të ardhmen? Shtrati i lumit Klina është i bazuar mirë në një projekt dhe parametra projektues por problem është ura. Shumica e urave në komunë kanë qenë gati të kolapsuara, nuk kanë pasur mundësi që të kalojnë sasi të mëdha të ujit. Kërkoj nga qeveria që të formojmë trupa të përbashkëta për vlerësimin e situatës dhe të një projekti për dalje nga kjo krizë. Nuk e përjashtoj që nuk ka gabime gjatë vlerësimit të dëmeve por gabimet do të i përmirësojmë në të ardhmen.

**z. Kushtrim Haliti:** Dëshiroj edhe një herë për drejtorin Millaku që tha se komisioni e ka vlerësuar shumë mirë situatën e krijuar. Po ndalem edhe një herë tek numri 82 në listë, nuk e di si është vlerësuar mirë me 1050 euro ndërkaq krejt shtëpia është e qarë. Edhe plato e parë e katit edhe komplet shtëpia.

Në vazhdim kishte një reagim dhe kundër reagim mes z. Haliti dhe kryesuesit Gashi në lidhje me donacionet dhe thirrjet e bashkësisë islame për ndihmë vetëm për Skenderaj dhe Mitrovicë dhe jo edhe për Klinë.

**z. Zafer Gashi:** Dëshiroj edhe një herë rreth shumës që duhet dhënë të prekurve nga vërshimet e dhjetorit 2022. A do të shpërndahen ato 86.000 euro që i kemi nda për ta? Po ashtu ka qenë edhe në TV që është bërë thirrje për donacione komunave të prekura nga vërshimet. A është hapur ndonjë llogari bankare për donacione për Klinën dhe a janë mbledhur mjete deri me tani?

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Vlera prej 86.000 euro që është ndarë ka pasur një afat të limituar për pagesë sepse ishte afër mbylljes vjetore të buxhetit. Raportin e parë e kemi dërguar në qeveri dhe shpresojmë që do të ndihmojë. Buxheti nuk është hapur deri me tani prandaj duhet të presim

kompensimin që do të vijë nga qeveria, shpresoj që do të vijnë të dy kompensimet njëherazi. Do ta marrim një raport se pse nuk ju kanë kompensuar dëmet familjeve dhe bizneseve të prekur në dhjetor të 2022. Arsyeja kryesore mendoj që ka qenë sepse afati ka qenë i kufizuar dhe nuk është arritur që të regjistrohen si furnitor. Posa të lëshohet buxheti do të i kryejmë obligimet që kanë mbetur. Ndërsa deri me sot janë grumbulluar si donacione 23 mijë euro.

**z. Kolë Prenaj:** Përshëndetje të gjithëve. Jemi duke e diskutuar një raport të fatkeqësive natyrore. Kryetari e elaboroj shumë mirë, të tjerat që u thanë le të mbesin në ndërgjegjen e çdo njeri. Tek Bizneset po shihet që është një buxhet shumë i fryrë. Çështje tjetër është se shpesh kam diskutuar edhe unë- çka për të ardhmen. Mendoj që brenda dy viteve do të zgjidhet problemi i lumit Klina dhe të evitohet dëmet. Sa kam qenë drejtor i inspektoratit është bërë një vlerësim ku janë elementet që krijojnë dëme në atë zonë, është mirë të shikohet ai raport. Nuk është në pyetje vetëm ndotja, ujërat e zeza por edhe humbjet e tokave.

z. Prenaj vazhdoi duke folur për studimet e tokave që i ka bërë një ekip holandez. Grupi lokal i veprimtari etj. "Le të i studiojmë gjerat dhe të përgatitemi për një konferencë me donator." Tha zoti Prenaj në fund.

**z. Esat Raci:** Sa i përket parandalimit të vërshimeve, natyrisht që është përgjegjësi e të gjithë neve por më së shumti e ekzekutivit. Unë përsëri propozoj që të gjithë qytetarëve të ju epët mundësia që të bëjnë ankesa dhe të shqyrtohen ankesat e tyre. Jemi për aprovimin e raportit dhe sa më shpejt të qohet raporti në qeveri, por të shikohet edhe mundësia për ridestitim të mjeteve.

**z. Arben Limanaj:** Këtë që e tha Esati e kisha edhe unë në mendje. Kërkohej që ky raport të votohet dhe me urgjencë të shkoj në qeveri. A ka mundësi që pas një vlerësimi të ankesave komuna të ndajë mjete shtesë? D.m.th. të formohet një komision tjetër dhe të i shqyrtojë ankesat dhe të bëhet vlerësim.

**z. Zenun Elezaj, kryetar:** Mendoj që fillimisht të na vijë shuma e kompensimit nga qeveria dhe më pastaj do të jemi bashkë që të marrim vendim për ridestitim të mjeteve. Dokumenti duhet ta fitoj formën e prerë fillimisht. Kam bërë kërkesa të shumta për marrjen e fondeve në ministri të linjës për përmirësimin e argjaturave të lumenjve dhe urave. Sidoqoftë bashkë do të jemi në krahë të të dëmtuarve nga vërshimet.

Kryesuesi z. Fadil Gashi tha se është një propozim i Valmiri Bacaj por se me rregullore nuk parashihet komisioni për shqyrtimin ankesave. Formën se si të ju bëjmë zgjidhje ankesave të të prekurve duhet ta gjejmë bashkë. Është normale edhe nëse është gabuar në ndonjë rast sepse puna është bërë urgjente nga komisioni dhe ka pasur volum të madh të punës. Draft raporti të votohet me këto ndryshime që ju i keni pranuar. Zyra ligjore bënë mirë të na ndihmoj se si të veprojmë për disa raste të veçanta ku nuk janë bërë vlerësimet shkak se shtëpitë kanë qenë të mbyllura pasi që kanë qenë jashtë Kosovës dhe disa raste të tjera që kanë nevojë që të trajtohen serish.

**z. Driton Raci, zyra ligjore:** Siç u përmend edhe nga kryetari edhe nga kryesuesi, rregullorja e qeverisë nuk e ka paraparë formimin e komisionit për shqyrtimin ankesave por Nëse ka ankesa është mirë që komisioni i njëjtë të bëjë rishikimin. Ligji i procedurës administrative parasheh që palët e pakënaqura ndaj aktit kanë të drejtë ankesë por rregullorja e qeverisë nuk e ka paraparë një komision të ankesave.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Mendoj që të gjitha ankesat që akne ardhur nga drafti i parë janë marrë parasysht por nëse ka ndonjë rast nga anëtarët e kuvendit, me procesverbal komisioni të i trajtoj. Sot është mirë që të votohet ky raport dhe të dërgohet në qeveri duke qenë të hapur ndaj qytetarëve dhe ankesave të tyre gjithsesi.

Kryesuesi z. Gashi tha se nëse anëtarët e kuvendit pajtohen, të merren rastet, numrat që ju referuan anëtarët, të i mbetet detyrë e komisionit që të i shqyrtoj." Gjitha vërejtjet që u dhanë ju them që të i shikoni edhe një herë sepse shumë prej atyre që ju i thatë këtu veçse janë futur në vlerësimin e komisionit d.m.th. janë rishikuar" tha kryesuesi Gashi.

**z. Esat Raci:** Atë e mendoj edhe unë, qytetarët që akne ankesa të vijnë te komisioni dhe të konsultohen bashkë në një afat të caktuar prej 5 ose 7 ditëve.

z. Zafer Gashi propozoj që të thirrën të gjitha bizneset dhe të i dëgjojë kryetari ata se çfarë kanë për të thënë sepse ka dallime të mëdha të vlerësimeve tek bizneset.

**z. Fadil Gashi, kryesues:** Unë kam informacione që një pjesë e bizneseve janë të siguruar dhe se kompanitë e sigurimeve veç se jua kanë bërë vlerësimin. Kam dëshirë që të kemi mirëkuptim se komunën nuk duhet parë si një market të thyer dhe të vrapohet për të marr kush sa më shumë që të mundet. Kapacitetet tona janë të fokusuara për vlerën e dëmeve dhe të shohim se sa do të na ndihmoj qeveria. Sot duhet të mbyllet kjo çështje dhe të votohet pro ose kundër ky raport. në vazhdim ne do të i shohim të gjitha mundësitë edhe të rishikimit edhe të rivlerësimit por edhe të ridestinitimit të mjeteve.

z. Tunë Dedaj propozon që të votohet komisioni kështu siç është. Familjeve që nuk kanë qenë në Kosovë dhe kanë pasur dëme kur të vijë në Kosovë të kontaktoj me komisionit dhe më pastaj me mjete të buxhetit të komunës të i bëhet kompensimi.

**Me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA raporti bashkë me draftin dhe ndryshimet.**

Kryesuesi z. Fadil Gashi tha se është edhe një kërkesë tjetër që ka ardhur dhe kërkohet vendimi i Kuvendit është për ndarjen e mjeteve – mbulimin e shpenzimeve për tri familje- kompensim të qirasë mujore të cilat akne mbetur pa shtëpi shkaku i vërshimeve. Është fjala për Safete Prokshi, Butrint Sferka dhe Shqiponje Desku, të gjithë nga Klina. Shuma është nga 900 euro dhe mjetet ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve nga zyra e kryetarit.

**Me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA**

Me miratimin e kërkesës së fundit përfundojnë punimet e seancës së jashtëzakonshme.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

